



FEDERATA ATLETIKE E KOSOVËS

RREGULLORE PËR REGJISTRIM  
TË ANËTARIT  
(klubeve dhe organizatave)

Prishtinë, Dhjetor 2022

Në bazë të nenit 35 të Statutit të Federatës së Atletike të Kosovës, Bordi i Federatës në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më 03.12.2022 nxjerr:

## RREGULLORE PËR REGJISTRIM TË ANËTARIT

### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

Kjo rregullore përcakton, normat, kriteret dhe procedurat për anëtarësimin e klubeve / organizatave sportive në Federatën Atletike të Kosovës (në testin e mëtejme Federata).

#### Neni 2

Aktivitetet në fushën e atletikës, të cilat janë edhe në përgjegjësinë e Federatës, mund t'i realizojnë vetëm klubet që janë të regjistruara pranë ministrisë gjegjëse dhe të jenë të themeluara në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare dhe të plotësojnë normat dhe kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore.

#### Neni 3

Të gjitha klubet / organizatat sportive të atletikës në Kosovë të cilat dëshirojnë të jenë Anëtar në Federatës janë të obliguara ti nënshtrohen procesit të vlerësimit për anëtarësim.

Klubet e atletikës mund të kryejnë aktivitete sportive dhe veprimtari sportive të atletikës në qoftë se ju përshtaten normave profesionale sportive dhe organizative, prandaj duhet të kenë:

1. atlet të anëtarësuar në klubin e tyre;
2. profesionistë (trajner) të atletikës të angazhuar, në varësi të llojit të veprimtarisë dhe të sigurojnë dëshmi për nivelin e edukimit të angazhuarve;
3. të siguruar hapësirën e përshtatshme, respektivisht infrastrukturë optimale për ushtrimin veprimtarisë sportive, pajisje dhe rekuizita atletike;
4. organizim të brendshëm të përshtatshëm dhe burime financiare për të marrë pjesë në aktivitetet atletike.
5. anëtarësimin e saj gjithëpërfshirëse në aspektin gjinor dhe të ofroj ambient të mirë për përfshirjen e komuniteteve të cilat njihen me Kushtetutë dhe legjislacionin përkatës;
6. nxisin dhe promovojnë vlerat sportive, konkurrencën e lirë sportive dhe respektimin e lirisë së ushtrimit të veprimtarisë.
7. përfaqësim të bazuar në rregullat e brendshme për organizimin dhe funksionimin e një subjekti joqeveritar dhe të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.
8. të shlyer të gjitha detyrimet financiare në përputhje me vendimin e shumës së regjistrimit të klubit në FAK.
9. monitorim të vazhdueshëm shëndetësor të të gjithë atletëve me të cilët zhvillon aktivitet fizik duke marrë parasysh disiplinën në të cilën atletët stërviten dhe garojnë.
10. respektim të gjithë legjislacionit në fuqi të Federatës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Atletikës Botërore;
11. gatishmëri për luftimin e dopingut në sportin e atletikës;
12. gatishmëri për luftimin e dhunës dhe dukurive negative në Sport nëse ato paraqiten në çdo moment.
13. dërguar kërkesë në FAK për monitorim të kuvendit themelues të klubit/organizatës,

#### Neni 4

Klubet e atletikës mund të anëtarësohen në Federatë të atletikës në qoftë se në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë rregullore duhet të sjellin për vlerësim dokumentacionin në vijim:

1. Certifikatë - kopje e noterizuar e regjistrimit të OJQ-së apo tjetër;
2. Certifikatë - kopje e noterizuar e numrit fiskal apo tjetër;
3. Aktin e themelimit;
4. Listën e nënshkruar të delegatëve pjesëmarrës të kuvendit themelues (së paku 15 delegat me numra personal të tyre),
5. Procesverbalin nga mbledhja themeluese apo konstituive e Kuvendit të klubit,
6. Konfirmim të përfaqësuesit të autorizuar të klubit;
7. Vendimin që dëshmon se klubi është i regjistruar dhe zhvillon veprimtari në një komunë përkatëse në Republikën e Kosovës, i cili vendim lëshohet nga drejtoria përkatëse për sport;
8. Konfirmimin e llogarisë bankare
9. Vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve tatimore;
10. Dëshminë mbi numrin e atletëve dhe të dhënat e anëtarëve të Bordit dhe detyrat udhëheqëse të anëtarëve të klubit;
11. Dëshminë mbi kualifikimin e trajnerëve të klubit, (të licencuar nga FAK-u);
12. Strukturat apo komisionet për administrimin e procedurave disiplinore dhe të mbrojtjes së të drejtave të atletëve;
13. Logon e klubit dhe ngjyrat zyrtare të klubit;
14. Vulën e klubit;
15. Kopjen e pagesës për anëtarësim në FAK;
16. Adresarin e klubit – për klubin, kryetarin, sekretarin apo personin zyrtar dhe trajnerin;
17. Formulari 1 - për Anëtarësim i plotësuar, i nënshkruar nga Kryetari i klubit/organizatës dhe i vulosur.

#### Neni 5

Anëtarësimi në Federatën Atletike të Kosovës arrihet duke hartuar dhe miratuar aktet juridike të përcaktuara nga ligjet dhe rregulloret në fuqi të cilat sipas nevojës duhet përshtatur dhe harmonizuar. Dokumentet legjislative të nevojshme për anëtarësim janë:

1. Statutin e organizatës;
2. Rregulloren e punës së kuvendit,
3. Rregulloren e këshillit mbikëqyrës,
4. Rregulloren e punës së Bordit,
5. Rregulloren disiplinore,

### PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË ANËTARËVE

#### Neni 6

1. Procedurat e vlerësimit të kritereve dhe normave i kryer Komisioni për Regjistrim të Anëtarëve të FAK-ut (në tekstin e mëtejme Komisioni) në bashkëpunim të plotë me Sekretarin e përgjithshëm të FAK-ut (në tekstin e mëtejme Sekretari).

2. Komisionin me propozim të Sekretarit të Federatës e emëron Bordi i FAK-ut.
3. Mandati i Komisionit është katër (4) vjet.
4. Punët teknike të Komisionit i kryen Sekretari i FAK-ut, i cili pranon dokumentacionin e anëtarit, informon klubet që aplikojnë për gjithë procesin e anëtarësimit, komunikon me klube në rast të shfaqjes së nevojës për të përmbushur ndonjë kriter, normë apo plotësim të dokumentacionit.
5. Klubi atletik i cili dëshiron të bëhet Anëtarë i Federatës parashton kërkesë (plotëson dhe, nënshkruan dhe vulosë Formulari 1), për anëtarësim me normat dhe kriteret e përcaktuara në nenin 3, 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje. Kërkesën e dorëzon zyrtarisht tek sekretari duke u paraqitur në zyrën e federatës. I tërë dokumentacioni duhet të jetë edhe në mënyrë elektronike i skanuar, përfshirë edhe formularin 1. Më pas e përcjell tek Komisioni për regjistrim të Anëtarëve për procedurë të mëtutjeshme,
6. Dokumentet i shqyrtojnë dhe analizojnë anëtarët e Komisionit në përputhje me standardet e përshkruara në këtë Rregullore. Nëse dokumentacioni nuk është i plotë, Komisioni do të informojë parashtruesin e kërkesës për të plotësuar atë brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit. Në qoftë se deri në atë datë dokumentacioni nuk është i plotë, kërkesa për anëtarësim refuzohet.
7. Komisioni do të shqyrtojë vetëm dokumentacionin e plotë brenda një periudhe prej 20 ditësh nga kompletimi i dokumentacionit.
8. Në rastet kur kërkesa është refuzuar, Komisioni do të informojë parashtruesin e kërkesës, duke shpjeguar arsyet për mos pranimin e anëtarit nëpërmjet një dokumenti (shkreses).
9. Sekretari pas vlerësimit final të Komisionit njofton aplikuesin për rezultatin e vlerësimit dhe nëse ai është refuzim për anëtarësim, aplikuesi ka të drejtë që brenda afatit 15 ditë pas pranimit të njoftimit të paraqes ankesë në adresë të Federatës (ankesa duhet ti drejtohet Komisionit për Ankesa).
10. Komisioni për Ankesa pas njoftimit nga sekretari duhet të shqyrtoj ankesën e aplikuesit për anëtarësim në afat prej 15 ditëve.
11. Bordi i Federatës në bazë të vlerësimit të dy komisioneve paraprake i jep të drejtën apo i refuzon aplikuesit kërkesën për të qenë anëtar i përkohshëm deri në kuvendin e radhës.
12. Bordi i Federatës i propozon Kuvendit kërkesën e aplikuesit për anëtarësim nëse aplikuesi e plotëson edhe kriterin e fundit në nenin 7 të kësaj rregulloreje dhe nëse Kuvendi e aprovon kërkesën nga Bordi, aplikuesi bëhet Anëtar i përhershëm i Federatës Atletike të Kosovës.
13. E drejta e votës në kuvend është e përcaktuar me rregulloren e të drejtës së votës në Kuvend.

#### Neni 7

1. Anëtari i ri do të fitojë të drejtat dhe detyrat e anëtarësisë në momentin kur klubi të ketë ndjekur 1 sezonë të rregullt të garave me se paku 4 atletë pjesëmarrës të njëjtë në 4 gara të organizuara nga FAK-u.

#### Neni 8

1. Të gjitha klubet duhet të bëjnë regjistrimin vjetor në FAK.
2. Klubet duhet të paraqesin kërkesën për regjistrim vjetor në Zyrën e Administratës së Federatës në periudhën 1 janar – 28 shkurt.
3. Klub i cili përmbushë normat dhe kriteret për regjistrim sipas nenit 3, 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje konsiderohet që ka kryer regjistrimin vjetor.

4. Klubet anëtare të FAK-ut paguajnë anëtarësinë vjetore në FAK për shumën, mënyrën dhe afatet e përcaktuara nga Bordi i FAK-ut.
5. Pagesa e anëtarësisë duhet të bëhet përmes llogarisë bankare.

#### Neni 9

1. Në rast të ndryshimeve të kryesisë së klubit, anëtarëve ose trajnerit, klubi duhet të njoftojë me shkrim Zyrën Administrative të FAK-ut për këto ndryshime menjëherë pas ndryshimeve të bëra në klub.

#### Neni 10

##### Dispozitat e detyrueshme të statutit të anëtarit

Statuti i Anëtarit duhet të përmbaj se paku:

1. Qëllimet sportive dhe objektivat për arritjen e tyre;
2. Rregullat e qarta për anëtarësinë dhe humbjen e anëtarësisë në klub;
3. Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të klubit;
4. Organet udhëheqëse dhe kompetencat e tyre;
5. Përfaqësimin me autoritetet varëse;
6. Dispozitat për funksionimin, procedurat dhe autorizimet e komisionit disiplinor
7. Dispozitat për Luftimin e dopingut në sportin e caktuar;

#### Neni 11

Anëtarët e FAK-ut gëzojnë të drejtat e mëposhtme:

1. Të marrin pjesë në Kuvendin e Përgjithshme, të njihen më parë me rendin e ditës së çdo Kuvendi të Përgjithshme, të ftohen në Mbledhjen e Kuvendit e Përgjithshme në kohën e përcaktuar, të ushtrojnë të drejtën për të diskutuar dhe debatuar në Kuvend dhe të ushtrojnë të drejtën për të votuar. E aplikueshme për anëtarët me të drejt vote.
2. Të paraqesin propozime për t'u përfshirë në rendin e ditës së Kuvendit të Përgjithshme.
3. Të propozojnë kandidatë për zgjedhje dhe/ose emërim në organet përkatëse të FAK-ut. E aplikueshme për anëtarët me të drejt vote siç e parasheh statuti i FAK-ut.
4. Të marrin pjesë në gara (nëse është e zbatueshme) dhe/ose aktivitete të tjera sportive të organizuara nga FAK-u dhe të organizojnë gara tjera pasi ti ipet e drejte nga FAK-u dhe nën kujdesin e saj;
5. Të ushtrojnë të gjitha të drejtat e tjera që burojnë nga statuti dhe në përputhje me rregulloret dhe vendimet e FAK-ut;

#### Neni 12

Anëtarët kanë për obligim që të respektojnë të gjitha propozicionet, rregullat dhe legjislacionin në fuqi të Federatës dhe institucioneve varëse të saj.

Anëtarët duhet të zbatojnë vendimet e Federatës dhe janë përgjegjës për zbatimin e tyre. Statutet e klubeve atletike, anëtarë të Federatës, duhet të përcaktojnë që ata të kryejnë veprimtarinë sportive dhe pjesëmarrjes në gara sportive.

#### Neni 13

1. Çdo anëtarë e menaxhon punën e tij në mënyrë të pavarur dhe pa ndikim të papërshtatshëm nga palët e treta.

2. Organet e anëtarëve do të zgjidhen ose emërohen. Statutet e anëtarëve duhet të parashikojnë një procedurë demokratike që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve.
3. Organet e anëtarëve që nuk janë zgjedhur ose emëruar në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 më sipër, edhe mbi bazë të përkohshme, nuk do të njihen nga FAK-u.

#### Neni 15

Anëtarësia e një klubi në FAK ndërpritet në rastet kur Anëtari:

- nuk arrin të plotëson normat dhe kriteret nga neni 3, 4, dhe 5 i kësaj rregulloreje
- përjashtohet me vendim të kuvendit të FAK-ut
- nëse anëtari nuk mund të përmbushë normat dhe kriteret e përshkruara në rregulloren e regjistrimit të Anëtarit.
- me fshirje nga regjistri i OJQ-ve,
- nëse konstatohet se anëtari ka pushuar së vepruari ose nëse nuk ka mbajtur asamble për të paktën dy vjet;
- nëse numri i atletëve të klubit gjatë vitit zvogëlohet nën numrin e përcaktuar për regjistrimin e anëtarit,
- mos shlyerja e obligimeve financiarë ndaj FAK-ut për dy vite me radhë.
- nëse një anëtar dëmton përparimin e Federatës me veprimet e tij ose nuk arrin qëllimet dhe detyrat për të cilat është themeluar,
- me kërkesën e anëtarit me shpjegim.

Kur një anëtar në veprimet e tij dëmton mbarëvajtjen e Federatës ose nuk arrin qëllime dhe detyra të caktuara për të cilat është themeluar, Zyra e FAK-ut do ta paralajmërojë Komisionin për regjistrim të Anëtarëve me shkrim për mangësitë në punën e tij i cili do ta thërrasë Anëtarin të bëjë korrigjime. Nëse një anëtar vazhdon të veprojë në kundërshtim me dispozitat e Statutit të tij dhe të këtij Statuti edhe pasi të jetë paralajmëruar nga Komisioni për regjistrim të Anëtarëve, Bordi Ekzekutiv merr vendim që ti propozon Kuvendit që të marrë vendim për përjashtimin – suspendimin e tij nga anëtarësia në Federatë.

Kundër propozimit të Bordit Ekzekutiv me të cilin një anëtar përjashtohet nga anëtarësia në Federatë, anëtari mund të paraqesë ankesë brenda 15 ditëve nga marrja e dokumentit për përjashtim nga Bordit Ekzekutiv.

Ankesa vendoset nga Kuvendi i Federatës në seancën e parë të rregullt pasuese, i cili mund ta refuzojë ankesën dhe të konfirmojë vendimin e Bordit Ekzekutiv ose mund ta pranojë ankesën dhe të anulojë vendimin për përjashtimin nga anëtarësia.

#### Neni 16

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë ditë pas datës së publikimit në faqen zyrtare të Federatës.

Prishtinë, më  
03.12.2022



Kryetari i FAK-ut  
Halil Sylejmani